



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 1234/Prot
p

Durrës, më: 15.05, 2026

V E N D I M

Nr. 73, datë 15.05, 2026

PËR

**"MIRATIMIN E RREGULLORES SË KËSHILLIT TË ETIKËS SË
UNIVERSITETIT "ALEKSANDËR MOISIU", DURRËS"**

Në mbështetje të ligjit Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 36, neni 38 gërma (d) dhe neni 44; të ligjit nr.8480, date 27.5.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike"; të Statutit të UAMD-së, neni 15 "Funksionet e Senatit Akademik" pika 1 gërma (h) dhe neni 22; të Rregullores së UAMD-së, të Kodit të Etikës; të Kodit të Etikës në Kërkimin Shkencor; referuar Draft Rregullores së Këshillit të Etikës përcjellë nga Kryetari i Këshillit të Etikës, si dhe në relacionin e Drejtorisë Juridike, Nr.1191, datë 12.05.2026, pas përfundimit të procesit të konsultimit me strukturat dhe personelin e UAMD-së, si dhe në sugjerimet e anëtarëve të Senatit Akademik, në mbledhjen e datës 15.05.2026, Senati Akademik,

V E N D O S I :

1. Miratimin e Rregullores së Këshillit të Etikës së Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen:
 - Administratori
 - Zv. Rektorët
 - Drejtuesit e Njësive Kryesore
 - Drejtorët e Drejtorive
 - Këshilli i Etikës
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

Prof. Dr. Shkëlqim FORTUZI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS

RREGULLORE E KËSHILLIT TË ETIKËS SË UNIVERSITETIT "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS

*Miraturar me Vendimin Nr. 73 datë 15/05/2026 të Senatit Akademik të Universitetit
"Aleksandër Moisiu" Durrës*

KREU I: DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1: Baza Ligjore

Kjo Rregullore mbështetet në:

1. **Ligj Nr. 7961, datë 12.7.1995**, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë"
2. **Ligjin Nr. 80/2015**, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë".
3. **Ligjin Nr. 44/2015**, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", për çështjet procedurale të parregulluara shprehimisht në këtë Rregullore.
4. **Ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999** "Për funksionimin e organeve kolegiale të administratës shtetërore dhe enteve publike"
5. **Ligj Nr. 124/2024** "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale"
6. **Statutin dhe Rregulloren e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës (UAMD).**
7. **Kodin e Etikës**, miratuar me Vendimin nr. 9, datë 01.06.2012 të Senatit Akademik, ndryshuar me Vendimin nr. 56, datë 23.10.2017 të Senatit Akademik të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës.
8. **Kodin e Etikës në Kërkimin Shkencor të UAMD-së**, miratuar me Vendimin Nr. 7, datë 24.08.2020 të Senatit Akademik, Neni 17, i cili parashikon ngritjen dhe funksionimin e Këshillit të Etikës.

Neni 2: Qëllimi

Qëllimi i kësaj Rregulloreje është:

1. Të përcaktojë në detaje organizimin, përbërjen, kompetencat dhe mënyrën e funksionimit të Këshillit të Etikës në UAMD.
2. Të rregullojë në mënyrë të qartë dhe të detajuar procedurat e verifikimit dhe shqyrtimit të të gjitha rasteve të shkeljes së normave të përcaktuara në Kodin e Etikës, përfshirë por pa u kufizuar në shkeljet e integritetit në kërkimin shkencor, etikës akademike dhe çdo formë tjetër të sjelljes jo-etike në kuadër të veprimtarisë së institucionit.
3. Të garantojë një proces të rregullt ligjor, të drejtë dhe transparent në trajtimin e çështjeve etike, duke siguruar respektimin e të drejtës për t'u dëgjuar të palëve të interesuara.

Neni 3: Fusha e Zbatimit





1. Kjo Rregullore zbatohet për të gjithë personelin akademik, ndihmës-akademik, administrativ dhe studentët e UAMD-së, në të gjitha ciklet e studimit, kur shqyrtohen shkelje të parimeve dhe rregullave të parashikuara në Kodin e Etikës.
2. Fusha e veprimtarisë së Këshillit të Etikës përfshin kryerjen e procedurave të verifikimit dhe shqyrtimit të çdo shkeljeje të parashikuar në Kodin e Etikës, të kryer nga stafi akademik, stafi administrativ, studentët, si dhe çdo subjekt tjetër i lidhur me veprimtarinë e institucionit, si dhe marrjen e vendimeve mbi bazën e gjetjeve, në përputhje me sanksionet përkatëse. Interpretimi i kësaj rregulloreje nuk mund të çojë në kufizimin e fushës së zbatimit të Kodit të Etikës.

Neni 4: Parimet Themelore

Gjatë ushtrimit të funksioneve të tij, Këshilli i Etikës duhet të udhëhiqet nga parimet e mëposhtme:

1. **Parimi i Paanësisë dhe Objektivitetit:** Këshilli duhet të veprojë në mënyrë të pavarur nga Autoriteti Drejtues dhe të marrë vendime ekskluzivisht mbi bazën e provave dhe fakteve.
2. **Parimi i Konfidencialitetit:** Të gjitha informacionet dhe dokumentacioni i mbledhur gjatë procedurës së shqyrtimit konsiderohen konfidenciale, deri në momentin e shpalljes së vendimit përfundimtar, me qëllim mbrojtjen e dinjitetit të palëve.
3. **Parimi i Kontradiktoritetit (E Drejta për t'u Dëgjuar):** Personi ndaj të cilit ka filluar procedura ka të drejtë të njihet me akuzat/gjetjet dhe të paraqesë mbrojtjen, argumentet dhe provat e tij.
4. **Parimi i Shpejtësisë dhe Efektivitetit:** Procedura e shqyrtimit duhet të përfundohet brenda afateve të arsyeshme të përcaktuara në këtë Rregullore dhe Kodin e Etikës për të shmangur zvarritjet e panevojshme.
5. **Parimi i Proporcionalitetit:** Sanksioni i vendosur duhet të jetë në proporcion me shkallën e shkeljes së konstatuar.

KREU II: ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I KËSHILLIT

Neni 5: Përbërja e Këshillit të Etikës

1. Këshilli i Etikës përbëhet nga një numër prej (shtatë) 7 anëtarësh përcaktuar në nenin 16 të Rregullores së UAMD, përfshirë Kryetarin, dhe zgjidhet nga Senati Akademik i UAMD-së.
2. Anëtarët duhet të jenë personalitete me integritet të lartë moral dhe profesional dhe duhet të jenë pjesë e personelit akademik të UAMD-së, me gradë ose titull shkencor, duke përfaqësuar disiplina të ndryshme shkencore brenda institucionit sipas përcaktimeve në Rregulloren e UAMD.



3. Mandati i anëtarëve të Këshillit të Etikës është tre (3) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.
4. Në rastet kur një anëtar i Këshillit është në pamundësi për të ushtruar detyrën, ose përjashtohet për shkak të konfliktit të interesit (sipas Nenit 7 të kësaj Rregulloreje), ai nuk ka të drejtë vote dhe vendimmarrje.
5. Në përbërje të Këshillit të Etikës bën pjesë dhe sekretari teknik, si një strukturë e rëndësishme në organizimin dhe menaxhimin e këtij këshilli. Senati Akademik përzgjedh nga radhët e anëtarëve të Këshillit të Etikës, sekretarin e këtij këshilli.

Neni 6: Strukturat Drejtuese dhe Administrimi

1. Senati Akademik përzgjedh nga radhët e anëtarëve të Këshillit të Etikës, kryetarin e këtij këshilli.
2. Detyrat e Kryetarit përfshijnë:
 - a) Përfaqësimin e Këshillit të Etikës.
 - b) Thirrjen dhe drejtimin e mbledhjeve të Këshillit.
 - c) Sigurimin e zbatimit të kësaj Rregulloreje dhe Kodit të Etikës.
 - d) Nënshkrimin e vendimeve dhe korrespondencës zyrtare.
3. Në mungesë të Kryetarit, ky i fundit mund të delegojë detyrat e tij për një kohë të caktuar në delegim, në mënyrë që të sigurohet mbarëvajtja e procesit pranë Këshillit të Etikës, në të kundërt, nëse nuk delegohet një zëvendësues, dhe Kryetari mungon, Këshillin e drejton një përfaqësues i përkohshëm i zgjedhur prej anëtarëve të Këshillit të Etikës.
4. Administrimi teknik, regjistrimi dhe mbajtja e arkivës së Këshillit të Etikës realizohet nga Sekretari i Këshillit, i cili mban përgjegjësi të drejtpërdrejtë për ruajtjen, administrimin dhe integritetin e dokumentacionit. Anëtarët e Këshillit të Etikës ushtrojnë mbikëqyrje mbi respektimin e rregullave të administrimit dhe janë të detyruar të zbatojnë kërkesat e konfidencialitetit. I gjithë dokumentacioni i nënshtrohet rregullave të rrepta të konfidencialitetit.

Neni 7: Konflikti i Interesit dhe Përjashtimi

1. Çdo anëtar i Këshillit të Etikës duhet të shmangë çdo situatë që mund të krijojë konflikt interesi ose të komprometojë paanësinë gjatë shqyrtimit të një rasti, bazuar në Ligjin Nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.
2. Një anëtar duhet të vetë-përjashtohet (të heqë dorë) nga shqyrtimi i një rasti nëse:
 - o Ai ka lidhje bashkëshortore, gjaku (deri në shkallën e katërt), apo miqësie të ngushtë me personin nën shqyrtim (palën e interesuar).



- Ai ka marrë pjesë në procesin e dhënies së gradës shkencore/titullit akademik të personit nën shqyrtim.
 - Ai ka lidhje vartësie të drejtpërdrejtë akademike (mentor/doktorant) ose bashkëpunimi të ngushtë shkencor me palën e interesuar.
 - Ai ka shprehur publikisht një opinion mbi çështjen e caktuar para fillimit të shqyrtimit zyrtar.
3. Anëtari që gjendet në konflikt interesi, ka detyrimin ta deklarojë këtë fakt dhe të mos marrë pjesë në diskutim apo votim. Përndryshe, Këshilli ka të drejtë të vendosë për përjashtimin e tij me votim.

Neni 8: Mbledhjet dhe Vendimmarrja

1. Këshilli i Etikës mbledhet sa herë e kërkon Kryetari ose kur kërkohet nga shumica e anëtarëve të tij, por detyrimisht brenda afateve të caktuara për shqyrtimin e rasteve.
2. Për të qenë e vlefshme, mbledhja e Këshillit duhet të ketë kuorum. Kuorumi arrihet kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të tij.
3. Vendimet e Këshillit merren me shumicë të thjeshtë votash të anëtarëve të pranishëm. Në rast se votat janë të barabarta, vota e Kryetarit është vendimtare.
4. Për çdo mbledhje mbahet procesverbal, i cili përmban: listën e të pranishmëve, rendin e ditës, diskutimet kryesore dhe rezultatin e votimit për vendimin e marrë. Procesverbalet nënshkruhen nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.
5. Mbledhjet e Këshillit të Etikës nuk janë publike, me qëllim ruajtjen e konfidencialitetit të procedurës. Palëve të interesuara u garantohet e drejta për t'u dëgjuar dhe për të marrë pjesë në seancat e shqyrtimit të çështjes së tyre. Seancat e diskutimit dhe të vendimmarrjes zhvillohen me dyer të mbyllura.

KREU III: PROCEDURA E SHQYRTIMIT TË RASTIT

Neni 9: Fillimi i Procedurës së Shqyrtimit

1. Procedura e shqyrtimit nga Këshilli i Etikës fillon kryesisht me marrjen e Raportit të Verifikimit nga Komisioni i Integritetit Akademik (KIA), të Komisionit të Integritetit Akademik të Fakultetit (KIAF), ose me kërkesë të subjektit të interesuar.
2. Raporti duhet të përmbajë:



- Përshkrimin e detajuar të shkeljes së dyshuar (p.sh., lloji i plagjiaturës, falsifikimi i të dhënave).
 - Dokumentacionin mbështetës dhe provat e mbledhura.
3. Procedura mund të fillojë me iniciativë të Këshillit të Etikës, me kërkesë të Autoriteteve Drejtuese, si dhe të çdo anëtari personel akademik, ndihmës-akademik, administrativ dhe student, sipas përcaktimeve në Kodin e Etikës.

Neni 10: Faza e Parë: Vlerësimi Fillestar dhe Regjistrimi

1. Brenda dhjetë (10) ditësh pune nga marrja e raportit/kërkesës, Kryetari i Këshillit njofton anëtarët e Këshillit për tu njohur me raportin apo kërkesën dhe fton ata për të diskutuar mbi vlerësimin fillestar.
2. Gjatë vlerësimit fillestar, Këshilli vendos nëse:
 - Raporti është i plotë dhe i rregullt nga ana formale.
 - Shkelja e raportuar i nënshtrohet juridiksionit të Këshillit.
 - Janë konstatuar elemente faktike të mjaftueshme për të krijuar dyshim të arsyeshëm mbi ekzistencën e një shkeljeje, duke justifikuar fillimin e procedurës së hetimit të thelluar (verifikimit).
3. Nëse Këshilli vendos të vazhdojë procedurën, njoftohen palët e interesuara dhe caktohet data dhe ora e mbledhjes së KE për të shqyrtuar rastin.

Neni 11: Faza e Dytë: Hetimi (Verifikimi) i Thelluar

1. Pas vendimit për të vazhduar, Këshilli i Etikës kryen hetimin e thelluar (verifikimin) e fakteve dhe provave.
2. Këshilli ka të drejtë të:
 - Kërkojë dokumente, dëshmi, materiale, dhe informacione shtesë nga personeli akademik, ndihmës akademik, administrativ, studentët dhe Njësitë Kryesore të UAMD-së.
 - Thërrasë dëshmitarë ose palë të tjera të përfshira për të dhënë shpjegime me shkrim ose me gojë.
 - Angazhojë ekspertë të pavarur brenda UAMD-së, kur natyra e shkeljes kërkon ekspertizë specifike teknike ose shkencore.



Neni 12: E Drejta e Palës për t'u Dëgjuar (Parimi i Kontradiktoritetit)

1. Pas përfundimit të mbledhjes së provave, por para marrjes së vendimit përfundimtar, personit ndaj të cilit ka nisur procedura (pala e interesuar) i dërgohet zyrtarisht:
 - o Një njoftim për fillimin e procedurës.
 - o Dokumentacioni bazë i mbledhur (duke ruajtur konfidencialitetin e burimit fillestar nëse është rasti).
2. Palës së interesuar i lihet një afat kohor prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh pune për të paraqitur shpjegimet, provat dhe argumentet e tij/saj me shkrim.
3. Pala ndaj së cilës është propozuar ose ka nisur një procedim disiplinor që sjell pasoja për të, ka të drejtë të kërkojë me shkrim, që të dëgjohet në një mbledhje të Këshillit. Këshilli shqyrton kërkesën dhe thërret një seancë dëgjimore ku pala merr pjesë personalisht ose përfaqësohet nga një person i autorizuar. Seanca zhvillohet në mënyrë të dokumentuar dhe protokollohet, duke garantuar transparencë, të drejtën e mbrojtjes dhe respektimin e procedurave disiplinore.

Neni 13: Afatet Kohore të Shqyrtimit

1. Këshilli i Etikës duhet të përfundojë procedurën e verifikimit dhe të nxjerrë vendimin përfundimtar brenda një afati kohor maksimumi 60 ditë pune nga data e regjistrimit të rastit dhe njoftimit të tij në drejtim të Këshillit.
2. Ky afat mund të shtyhet vetëm një herë, deri në 30 ditë pune, me vendim të motivuar të Këshillit, ose më shumë kur kompleksiteti i çështjes ose nevoja për ekspertizë shtesë e bën të domosdoshme.

Neni 14: Raporti Përfundimtar i Shqyrtimit

1. Anëtarët diskutojnë dhe mbajnë procesverbal mbi përfundimet e dala nga procedura e shqyrtimit, dhe caktohet ndërmjet tyre detyra për të zbardhur vendimin përfundimtar të KE.
2. Procesverbali përfundimtar duhet të përmbajë në mënyrë të përmbledhur: faktet e konstatuara, vlerësimin e provave të mbledhura, argumentet e palës së interesuar dhe propozimin përfundimtar për vendimmarrje.

KREU IV: VENDIMMARRJA DHE SANKSONET



Neni 15: Marrja dhe Formulimi i Vendimit

1. Pas shqyrtimit të plotë e përfundimtar (sipas Nenit 14) dhe shpjegimeve të palës së interesuar, Këshilli i Etikës mblidhet për të marrë Vendimin Përfundimtar.
2. Vendimi merret me shumicë të thjeshtë votash të anëtarëve të pranishëm, bazuar në vlerësimin e fakteve dhe provave nëse është kryer shkelje e Kodit të Etikës. Anëtarët në marrjen e vendimit përfundimtar, nuk mund të abstenojnë në vendimmarrje.
3. Vendimi duhet të jetë me shkrim, i motivuar, i argumentuar, bazuar në provat e administruara dhe në ligj.
4. **Përmbajtja e Vendimit** duhet të përfshijë detyrimisht:
 - **Baza ligjore** (nenet specifike të Kodit të Etikës që janë shkelur).
 - **Faktet** e konstatuara.
 - **Gjetja** (konstatimi i shkeljes ose pushimi i çështjes).
 - **Masa e propozuar**, duhet të jete në përputhje me llojet e masave disiplinore të përcaktuara në Kodin e Etikës.
 - **Ankimimi** sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 16: Njoftimi i Vendimit

1. Vendimi i Këshillit të Etikës i njoftohet zyrtarisht personit të interesuar dhe Rektorit të Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës. Rektori, në ushtrim të kompetencave të tij, shqyrton dhe merr vendimin përfundimtar për rastet që lidhen me personelin akademik dhe ndihmës-akademik, në përputhje me aktet e brendshme të Universitetit. Për rastet që lidhen me personelin administrativ, Rektori ia përcjell për kompetencë dhe vendimmarrje vendimin Administratorit të Universitetit, i cili është autoriteti kompetent për shqyrtimin dhe marrjen e vendimit përfundimtar, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rregullat e brendshme të institucionit.
2. Njoftimi duhet të kryhet brenda 5 (pesë) ditësh pune nga data e marrjes së vendimit, duke përdorur mjetet zyrtare të komunikimit të UAMD-së, në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative.
3. Vendimi që përmban një masë disiplinore ose sanksion, njoftohet detyrimisht në formë të shkruar dhe i dorëzohet personit të interesuar në mënyrë të dokumentuar. Njoftimi kryhet përmes dorëzimit personal me firmë, ose kur kjo nuk është e mundur, përmes dërgesës postare me konfirmim marrjeje. Administrata është e detyruar të sigurojë që njoftimi të merret realisht në dorëzim, duke protokolluar çdo veprim të kryer. Çdo njoftim i pa dokumentuar nuk konsiderohet i vlefshëm për efektet e afateve dhe procedurave disiplinore.



Neni 17: Vlefshmëria e Vendimit dhe Ankimimi

Vendimi i arsyetuar i Këshillit të Etikës i paraqitet autoritetit kompetent të Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës për marrjen e vendimit përfundimtar administrativ, në përputhje me përcaktimet e Rregullores së Brendshme të Universitetit.

Autoriteti kompetent shqyrton vendimin e Këshillit të Etikës dhe bazohet në gjetjet dhe konkluzionet e tij për marrjen e vendimit përfundimtar.

Mosmarrja në konsideratë e gjetjeve, arsyetimi juridik ose masa e propozuar nga Këshilli i Etikës lejohet vetëm në raste të veçanta dhe duhet të jetë i shprehur, i arsyetuar në mënyrë të detajuar dhe i mbështetur në elementë të rinj fakti ose në interpretim të ndryshëm juridik, të argumentuar qartë në aktin përfundimtar.

Në mungesë të një arsyetimi të tillë të posaçëm, autoriteti kompetent konsiderohet se pranon gjetjet dhe propozimin e Këshillit të Etikës.

Kundër vendimit përfundimtar administrativ, personi i interesuar ka të drejtë ankimi në gjykatën kompetente, sipas afateve dhe procedurave të parashikuara në legjislacionin në fuqi.

E drejta e ankimit nuk pezullon ekzekutimin e vendimit, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe nga ligji ose vendoset nga gjykata.

Neni 18: Marrja dhe zbatimi i Sanksioneve nga Autoriteti Drejtues

Autoriteti kompetent i Universitetit, mbi bazën e vendimit të arsyetuar të Këshillit të Etikës, merr vendimin përfundimtar për vendosjen e masës disiplinore, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e brendshme të Universitetit.

Në ushtrimin e kësaj kompetence, autoriteti kompetent është i detyruar të kryejë një vlerësim të plotë dhe të argumentuar të gjetjeve të Këshillit të Etikës, duke respektuar parimet e ligjshmërisë, proporcionalitetit dhe të procesit të rregullt ligjor.

Në rast devijimi nga propozimi i Këshillit të Etikës, autoriteti kompetent duhet të arsyetojë në mënyrë të posaçme dhe të detajuar shkaqet e këtij devijimi, duke bërë një analizë krahasuese ndërmjet gjetjeve të Këshillit dhe vendimit përfundimtar.

Vendimi përfundimtar i autoritetit kompetent është i detyrueshëm për zbatim dhe shoqërohet me marrjen e masave përkatëse administrative.

Autoriteti kompetent njofton pa vonesë palët e interesuara dhe informon Këshillin e Etikës mbi vendimin e marrë dhe masat e zbatuara.



Në rastet kur nga shqyrtimi rezultojnë elementë të një vepre penale ose shkelje që tejkalojnë kompetencat e institucionit, autoriteti kompetent merr masa për referimin e çështjes pranë organeve ligjzbatuese.

KREU V: DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 19: Çështjet e Parregulluara dhe Zbatimi i Kodit të Procedurave Administrative

1. Për të gjitha çështjet procedurale, organizative dhe të veprimtarisë së Këshillit të Etikës që nuk rregullohen shprehimisht në këtë Rregullore, zbatohen parimet dhe dispozitat përkatëse të:
 - a) Kodit të Etikës në Kërkimin Shkencor të UAMD-së.
 - b) Statutit të UAMD-së.
 - c) Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë (Ligji Nr. 44/2015).
2. Në rast mospërputhjeje, dispozitat e Kodit të Etikës zbatohen për sa i përket përcaktimit të shkeljeve dhe sanksioneve, ndërsa kjo Rregullore zbatohet për procedurën e shqyrtimit të tyre.
3. Në raste të argumentuara dhe/ose emergjente, Këshilli i Etikës mund të mbajë mbledhjet e tij online, të verifikuara përmes platformave të miratuara nga UAMD.

Neni 20: Transparenca dhe Ruajtja e Dokumentacionit

1. Për të garantuar transparencën institucionale, vendimet e Këshillit të Etikës pas hyrjes së tyre në fuqi, mund të publikohen në faqen zyrtare të Universitetit, në formë të përmbledhur (pa të dhëna personale sensitive), me qëllim parandalimin dhe edukimin.
2. Anëtarët e Këshillit të Etikës dhe sekretari (sipas Nenit 6, pika 4) janë përgjegjës për arkivimin e rregullt të të gjithë dokumentacionit, provave, procesverbaleve dhe vendimeve të Këshillit të Etikës, duke respektuar rregullat për mbrojtjen e të dhënave personale dhe afatet ligjore të ruajtjes.

Neni 21: Mbrojtja e të Dhënave Personale

1. Në ushtrimin e veprimtarisë së tij, Këshilli i Etikës përpunon të dhëna personale në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, në veçanti me Ligjin nr. 124/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale".
2. Përpunimi i të dhënave personale kryhet vetëm për qëllime të lidhura drejtpërdrejt me shqyrtimin e çështjeve në kompetencë të Këshillit të Etikës dhe në masën e nevojshme për realizimin e tyre.



3. Këshilli i Etikës dhe çdo person i përfshirë në procedurë janë të detyruar të respektojnë parimet e ligjshmërisë, proporcionalitetit, konfidencialitetit dhe sigurisë së të dhënave personale.
4. Të dhënat personale, përfshirë të dhënat sensitive, trajtohen me masa të përshtatshme teknike dhe organizative për të garantuar mbrojtjen e tyre nga akses i paautorizuar, humbja, ndryshimi apo përhapja e paligjshme.
5. Aksesimi në të dhënat personale kufizohet vetëm për personat që janë të autorizuar dhe në masën e nevojshme për ushtrimin e funksioneve të tyre.
6. Ruajtja dhe përpunimi i të dhënave personale bëhet për një periudhë jo më të gjatë se sa është e nevojshme për qëllimin për të cilin janë mbledhur, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rregullat për arkivimin.
7. Subjektet e të dhënave personale gëzojnë të drejtat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi, për aq sa ushtrimi i tyre nuk cenon zhvillimin e procedurës.

Neni 22: Shfuqizimet

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, çdo dispozitë rregulluese e mëparshme e brendshme, apo akt administrativ i Universitetit që rregullon të njëjtën fushë veprimtarie, nuk zbatohet për aq sa është në kundërshtim me këtë Rregullore.

Neni 23: Hyrja në Fuqi

Kjo Rregullore miratohet nga Senati Akademik i Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës dhe hyn në fuqi menjëherë pas miratimit.